

VENDIM
Nr. 269, datë 9.5.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RRITJA E SIGURISË SË DIGËS DHE PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE
UJËMBLEDHËSE TË REZERVUARIT TË KURJANIT”, BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësive ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit”, Bashkia Roskovec.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 481 500 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 481 500 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Roskovec.

8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Roskovec për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Roskovec për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RRITJA E SIGURISË SË DIGËS DHE PËRMIRËSIMI I AFTËSISË UJËMBLEDHËSE TË REZERVUARIT TË KURJANIT”, BASHKIA ROSKOVEC

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim					Shënime (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
										“Arë”			Vlerat e kulturave bujqësore	Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturave bujqësore (lekë)		
1	Ilir	Shahin	Gega	3196	355/41	Arë	4000	13	152	4000	269	1,076,000	342,000	1,418,000	
2	Salë	Ramadan	Gega	3196	355/42	Arë	3000	13	153	3000	269	807,000	256,500	1,063,500	
Vlera totale														2,481,500	